



Udhëzues për shërbimet e migracionit dhe diasporës në Bashkinë Vlorë



albania.iom.int



1 Çfarë është struktura për migracionin dhe diasporën?

Struktura vendore për migracionin dhe diasporën është pjesë e bashkisë Vlorë dhe shërben si pikë kontakti për të informuar, udhëzuar dhe mbështetur qytetarët për çështjet që lidhen me migracionin dhe diasporën. Kjo strukturë është krijuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe ka si qëllim:



Të ofrojë informacion dhe ndihmë për qytetarët



Të mbështesë migrantët e kthyer dhe migrantët e brendshëm



Të nxisë bashkëpunimin me diasporën



Të lehtësojë qasjen në shërbime dhe mundësi zhvillimi



Nëpërmjet kësaj strukture, bashkia Vlorë bashkëpunon me institucione të tjera për të siguruar që çdo qytetar të ketë qasje në informacion të saktë dhe mbështetje konkrete.

2 Kujt i shërben kjo strukturë?

Shërbimet janë të hapura për të gjithë qytetarët e bashkisë Vlorë që kanë nevojë për informacion, udhëzime apo mbështetje në lidhje me migracionin, punësimin dhe angazhimin me diasporën. Ne synojmë të ofrojmë mbështetje të barabartë dhe të qasshme për çdo individ.

Këto shërbime mund t'i vijnë në ndihmë veçanërisht:

- Personave që po konsiderojnë lëvizjen brenda Shqipërisë për punë;
- Migrantëve të kthyer nga jashtë vendit;
- Diasporës së Vlorës nëpër botë;
- Të rinjve dhe grave që kërkojnë mundësi zhvillimi socio-ekonomik;
- Familjeve të migrantëve dhe të komunitetit të Vlorës në përgjithësi.



Qasja është praktike dhe e orientuar drejt nevojave të vërteta të qytetarëve, duke ofruar mbështetje në hapa dhe mundësi konkrete për punësim, integrim dhe zhvillim.



Punësim dhe formim profesional

Ne ju ndihmojmë të kuptoni më mirë tregun e punës dhe mundësitë që ekzistojnë për zhvillimin tuaj profesional, duke ju orientuar drejt shërbimeve dhe programeve të duhura:

- Informacion për mundësitë e punësimit në Shqipëri;
- Referim në zyrat rajonale të punës (AKPA) apo të bashkisë;
- Këshillim për trajnime profesionale;
- Ndërlidhje me mundësi punësimi në bashki të tjera të vendit.



Migrimi i brendshëm (lëvizja për punë brenda vendit)

Lëvizja për punë brenda Shqipërisë është një mundësi për zhvillim profesional dhe ekonomik. Struktura për migracionin dhe diasporën ju ndihmon ta bëni këtë proces më të lehtë me:

- Informacion për mundësitë e punësimit në bashki të tjera;
- Mbështetje për integrimin në zonën pritëse;
- Ndihmë për regjistrimin e fëmijëve në shkollë/kopsht;
- Qasje në shërbime shëndetësore dhe sociale;
- Informacion dhe mbështetje për strehimin dhe regjistrimin e adresës.



Emigrim i sigurt dhe i informuar jashtë vendit

Vendimi për të emigruar jashtë vendit është një hap i rëndësishëm që kërkon informacion të saktë dhe të besueshëm. Është e rëndësishme të kuptoni mundësitë dhe rreziqet, në mënyrë që të merrni vendime të informuara dhe të shmangni situatat e pasigurta:

- Informacion për mundësitë për migrim të rregullt;
- Këshillim për të shmangur migrimin e parregullt dhe rreziqet që lidhen me të;
- Orientim drejt institucioneve përkatëse.



Mbështetje për migrantët e kthyer

Rikthimi në Shqipëri mund të shoqërohet me sfida të ndryshme. Stafi i bashkisë Vlorë ju mbështet në riintegrimin tuaj, duke ju ndihmuar me:

- Informacion për procedurat administrative dhe dokumentacionin;
- Orientim në tregun e punës dhe mundësi punësimi;
- Referim në shërbime sociale, arsimore dhe shëndetësore;
- Informacion për mundësi vetëpunësimi dhe biznesi.





Shërbime sociale dhe jetësore

Qasja tek shërbimet bazë është thelbësore për mirëqenien tuaj. Ne ju ndihmojmë të orientoheni dhe të përfitoni nga shërbimet që ju takojnë:

- Informacion për ndihmën ekonomike;
- Referim për mbështetje sociale dhe psikologjike;
- Ndihmë për mbrojtje sociale dhe shërbime për grupet e cënueshme;
- Koordinimin e aplikimeve dhe përfitimeve nga programet sociale të strehimit;
- Ndihmë për qasje në shërbime shëndetësore;
- Ndihmë dhe qasje në shërbime për arsimimin e fëmijëve;
- Mbështetje për fëmijët me nevoja speciale;
- Ndihmë lidhur me shërbimet e gjendjes civile;
- Ndihmë për përdorimin e platformës e-Albania.



Mbështetje për diasporën

Diaspora luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Staf i migracionit dhe diasporën i vjen në ndihmë angazhimit të diasporës së Vlorës nëpërmjet:

- Informacion për investime dhe hapje biznesi;
- Lidhje me institucionet vendore;
- Mbështetje për nisma komunitare, arsimore dhe kulturore;
- Mundësi për mentorim dhe përfshirje të rinjve;
- Informacion për marrjen e nënshtetësisë shqiptare.



Mbështetje për të Huajt

- Ndihmesë në dhënien e informacionit për përfitimin e lejes së qëndrimit dhe lejes unike;
- Ofron shërbime integrimi për të huajt në shoqërinë shqiptare;
- Siguron mundësi në qasje në shërbime të ndryshme.





Mbështetje për Regjistrimin e Biznesit

Migrantët e brendshëm apo Diaspora që duan të krijojnë një aktivitet ekonomik në qytetin e tyre mund të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), përmes platformës e-Albania. Në bashki ata marrin:

- Informacion për investime dhe hapje biznesi; Regjistrimi është pa kosto dhe kryhet brenda afateve të shkurtra, duke siguruar që bizneset të operojnë ligjërisht;
- Mbështetje për procedurat fiskale;
- Informacion për mundësitë e financimit, hapësirat për zhvillimin e bizneseve dhe programet mbështetëse;
- Identifikimin e mundësive për subvencione dhe grante, si dhe në orientimin për shërbimet e ofruara nga qendrat rajonale të zhvillimit ekonomik.

3 Mbështetje e personalizuar

Çdo individ ka nevoja dhe objektiva të ndryshme, ndaj mbështetja bazohet në një qasje të personalizuar. Ne do të punojmë sëbashku për të kuptuar situatën tuaj dhe për të ndërtuar një plan konkret zhvillimi.

Një nga mjetet kryesore është Plani Individual i Punësimit dhe Edukimit, përmes të cilit bëjmë:



Vlerësim të aftësive dhe nevojave tuaja



Hartim të një plani të personalizuar për karrierën



Orientim drejt trajnimeve dhe mundësive të punësimit



Mbështetje dhe ndjekje gjatë gjithë procesit



Ne synojmë të krijojmë një marrëdhënie besimi me çdo qytetar, duke ofruar mbështetje profesionale dhe të drejtë; duke ofruar trajtim të barabartë dhe pa diskriminim; komunikim të qartë dhe me respekt; si edhe duke siguruar privatsinë dhe mbrojtje të të dhënave.



Si mund të merrni shërbim?

1

Kontaktoni sektorin e migracionit dhe diasporës pranë bashkisë Vlorë

2

Plotësoni një formular të thjeshtë regjistrimi

3

Takoheni me specialistët përkatës

4

Merrni udhëzime sipas nevojave tuaja

5

Referoheni tek shërbimet përkatëse.



Kontaktoni



info@vlora.gov.al



<https://vlora.gov.al/diaspora/>



E hënë - E premte: 08:00-16:00



Ky material është përgatitur me mbështetjen e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), në kuadër të projektit "Forcimi i kapaciteteve institucionale vendore për migracionin në Shqipëri", mbështetur nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar.

